



Nr. 2974/6 / datë 15.12. 2011

PROKURORIA E PËRGJITHSHME



Nr. 3602/7 / datë 24.02. 2011

MINISTRIA E BRENDSHME

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 03 , datë 15.12. 2011

“PËR PROCEDIMIN DISIPLINOR TË PUNONJËSVE TË POLICISË GJYQËSORE”

Në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, gërma “gj” e ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), të nenit 7, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”,(i ndryshuar) dhe të nenit 15, pika 9 të ligjit nr. 8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J M Ë:

Neni 1

Rregulla të përgjithshme

1. Punonjësit e Policisë Gjyqësore i nënshtrohen procedimit disiplinor sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” dhe dispozitave vijuese të këtij udhëzimi.
2. Procedimi disiplinor u nënshtrohet parimeve të ligjshmërisë, objektivitetit, gjykimit me gojë dhe kontradiktoritetit në përputhje me rregullat e procesit të rregullt ligjor.
3. Procedimi disiplinor është i pavarur nga procedimi penal ku punonjësi ka kryer funksionet e oficerit ose agentit të Policisë Gjyqësore.
4. Kur gjatë procedimit disiplinor rezultojnë të dhëna se punonjësi i Policisë Gjyqësore ka kryer një vepër penale që ndiqet kryesisht, kryesuesi i komisionit disiplinor paraqet kallëzim në prokurorinë kompetente, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.
5. Ka konkurrim të shkeljeve disiplinore në rastet kur punonjësi i Policisë Gjyqësore kryen dy ose më shumë shkelje dhe kur vendimi që cakton masën disiplinore për njërën prej tyre nuk ka marrë ende formë përfundimtare.
6. Në rastin e konkurrimit të shkeljeve disiplinore jepet një masë e vetme. Kur shkeljeve të konstatuara u përkojnë masa të ndryshme disiplinore, propozohet masa më e rëndë.
7. Për zgjedhjen e masës disiplinore mbahet parasysh rëndësia e faktit, forma e fajit të punonjësit të Policisë Gjyqësore, rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes.

Titullari i emërtesës, pranon ose refuzon kërkesën për dhënien e masës disiplinore në mënyrë të arsyetuar.

8. Procedimi disiplinor ka karakter të rezervuar. Ndalohet publikimi apo përhapja në çdo formë e të dhënave, gjersa punonjësi i proceduar nuk ka marrë dijeni për to. Për qëllime të mbrojtjes punonjësi dhe kolegu ose avokati që e asiston gjatë procesit disiplinor kanë të drejtë të marrin kopje të akteve që ndodhen në dosjen disiplinore.

Neni 2

Fillimi i procedimit disiplinor

1. Procedimi disiplinor ndaj punonjësit të Policisë Gjyqësore fillon kryesisht nga Prokurori i Përgjithshëm, drejtuesi i prokurorisë si dhe nga prokurori kompetent për çështjen në të cilën është kryer shkelja disiplinore me miratimin e drejtuesit të prokurorisë si dhe mbi bazën e një kërkesë me shkrim drejtuar atij nga çdo organ ose person i interesuar.
2. Procedimi disiplinor fillon brenda 6 (gjashtë) muajve nga zbulimi i shkeljes, por jo më vonë se 3 (tre) vjet nga kryerja e shkeljes.
3. Kalimi i çdonjërit prej këtyre dy afateve passjell shuarjen e përgjegjësisë disiplinore.
4. Çasti i zbulimit të shkeljes konsiderohet data e përpilimit të aktit me shkrim, në të cilin trajtohet shkelja.

Neni 3

Urdhri për fillimin e procedimit disiplinor

1. Në urdhrin për fillimin e procedimit përshkruhen në mënyrë të përmbledhur natyra e shkeljes/ve dhe elementët e faktit për të cilat çmohet se duhet të fillohet procedimi disiplinor.
2. Drejtuesi i Prokurorisë, i komunikon urdhrin punonjësit të policisë gjyqësore të proceduar, si dhe ndjek procedurën deri në shqyrtimin e procedimit disiplinor nga Komisioni disiplinor.
3. Kur procedimi disiplinor fillon me kërkesë të organit apo personit të interesuar, kërkesa i njoftohet Prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrit, që ka në kompetencë forcën policore.
4. Kur pas fillimit të procedimit disiplinor konstatohen shkelje të tjera të natyrës së parashikuar nga neni 14 të ligjit Nr. 8677 datë 12.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" urdhërohet plotësimi i objektit të procedimit disiplinor.
5. Punonjësit të policisë gjyqësore të proceduar i jepet koha e mjaftueshme sipas udhëzimit për të realizuar mbrojtjen e tij, për objektin e shtuar.

Neni 4

Regjistri i procedimit disiplinor

1. Urdhri për fillimin e procedimit disiplinor regjistrohet në regjistrin e procedimeve disiplinore i cili mbahet në sekretarinë e prokurorisë ku është filluar procedimi disiplinor.
2. Rregullat për mbajtjen e regjistrit caktohen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 5

Relacioni për fillimin e procedimit disiplinor dhe përmbajtja e tij

1. Bashkëlidhur urdhrin për fillimin e procedimit disiplinor, përpilohet relacioni i procedimit disiplinor.
2. Relacioni për fillimin e procedimit disiplinor përmban:
 - a) të dhëna të detajuara për shkeljet e përmendura në urdhrin për fillimin e procedimit disiplinor;
 - b) të dhëna të tjera të cilat janë të administruara në dosjen personale të punonjësit të policisë gjyqësore të proceduar që kanë të bëjnë me vlerësimet e mëparshme të tij, me masat disiplinore në ngarkim të tij, nëqoftëse ka, tregues të tjerë që kanë të bëjnë me qëndrimin etiko-moral të punonjësit të policisë gjyqësore si dhe çdo të dhënë tjetër që i shërben procedimit disiplinor.

Neni 6

Njohja me dokumentacionin e procedimit

1. Drejtuesi i Prokurorisë i komunikon punonjësit të policisë gjyqësore, urdhrin për fillimin e procedimit disiplinor dhe relacionin përkatës, si dhe i cakton një afat, brenda dhjetë ditëve, për të përgatitur kundërshtimet e tij.
2. Njoftimi i punonjësit të policisë gjyqësore bëhet nga sekretaria e prokurorisë ose nëpërmjet shërbimit postar, duke i dorëzuar kopjen e aktit të interesuarit. Në rast se njoftimi bëhet nga sekretaria e prokurorisë, bëhet shënim në dëftesën e komunikimit, për dorëzimin dhe për datën. Njoftimi mund të bëhet edhe me mjete teknike të përshtatshme që garantojnë njoftimin, me kusht që të dokumentojnë njohjen e punonjësit të policisë gjyqësore me aktet e procedimit disiplinor.

Neni 7

Njohja e anëtarëve të Komisionit Disiplinor me dokumentacionin e procedimit

1. Drejtuesi i Prokurorisë vë në dispozicion të çdo anëtari të Komisionit Disiplinor një kopje të dokumentacionit për procedimin disiplinor të punonjësit të policisë gjyqësore, jo më vonë se tre ditë përpara datës së vendosur për mbajtjen e mbledhjes.
2. Dokumentacioni përbëhet nga urdhri për fillimin e procedimit disiplinor, relacioni i detajuar i shkeljeve, dëftesa e komunikimit dhe aktet e mbrojtjes së punonjësit të policisë gjyqësore të proceduar, nëse ky i fundit ka paraqitur mbrojtjen e tij.

Neni 8

Njoftimi i datës së mbledhjes së Komisionit Disiplinor

1. Drejtuesi i Prokurorisë cakton datën e mbledhjes së parë së Komisionit Disiplinor që do të shqyrtojë procedimin disiplinor, brenda 30 ditëve nga dalja e urdhrin.
2. Drejtuesi i Prokurorisë njofton punonjësën e policisë gjyqësore ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor dhe anëtarët e Komisionit Disiplinor për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën tre ditë përpara fillimit të saj.

Neni 9
Shqyrtimi i procedimit disiplinor nga Komisioni Disiplinor

1. Mbledhja fillon me verifikimin e paraqitjes së palëve, verifikimin nëse punonjësi është njohur me objektin e procedimit disiplinor dhe provat në ngarkim të tij, parashtrimin hyrës të prokurorit dhe kërkesën e tij për marrjen dhe shqyrtimin e provave.
2. Punonjësi i Policisë Gjyqësore i proceduar dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të paraqesin kundërshtimet e tyre dhe të kërkojnë marrjen e provave të tjera.
3. Nëse palët e çmojnë të nevojshme, në ditën e caktuar për shqyrtimin e shkeljes, mund të kërkojnë thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve, për të sjellë fakte rreth çështjes. Punonjësi dhe përfaqësuesi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm kur dëshmitaret sjellin fakte dhe t'i pyesin ata për faktet e sjella prej tyre.
4. Gjatë shqyrtimit disiplinor duhet të zbatohet parimi i kontradiktoritetit. Mbledhjet e komisionit pasqyrohen në procesverbal në formë të përmbledhur.
5. Kur konstatohen shkelje shumë të rënda disiplinore në veprimtarinë e punonjësit të policisë gjyqësore, parashikuar nga neni 14/a, paragrafi 4 i ligjit, gjatë shqyrtimit administrativ të shkeljes, Komisioni mund t'i propozojë titullarit pezullimin e punonjësit të proceduar nga ushtrimi i funksioneve të Policisë Gjyqësore.

Neni 10
Marrja e vendimit nga Komisioni Disiplinor

1. Komisioni disiplinor para marrjes së vendimit verifikon edhe:
 - a) dokumentacionin përkatës, për mospërputhje, për fakte që mungojnë, data apo firma që janë hequr, etj.;
 - b) dosjen e punonjësit;
 - c) praktikat dhe rastet e procedimeve disiplinore të mëparshme;
 - ç) masat disiplinore të dhëna për punonjësit e tjerë që kanë kryer të njëjtat shkelje;
 - d) praninë e faktorëve apo rrethanave rënduese ose lehtësuese për të dhënë masën disiplinore, duke përfshirë por pa u kufizuar, mënyrën e kryerjes së shkeljes, kryerjen në të njëjtën kohë të më shumë se një shkelje disiplinore, përvojën në punë, qëndrimin e punonjësit ndaj shkeljes deri në çastin e fillimit të procedimit disiplinor, etj;
 - dh) qëndrimin e punonjësit për masa të dhëna në të shkuarën për të njëjtën lloj shkelje;
 - e) rezultatet individuale në punë.
2. Brenda 30 ditëve nga data e mbledhjes së parë, Komisioni me shumicë votash, vendos t'i propozojë titullarit të emërtesës, vendimin e tij të arsyetuar për dhënien e masës disiplinore. Në rastet kur komisioni çmon se nuk duhet propozuar masë disiplinore, vendos pushimin e procedimit disiplinor.
3. Propozimit për masë disiplinore dhe vendimit të pushimit u bashkëlidhet mendimi i pakicës. Ato u njoftohen palëve dhe titullarit të emërtesës, me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga drejtuesi i prokurorisë.

Neni 11
Ndërprerja dhe pezullimi i procedimit disiplinor

1. Procedimi disiplinor ndërpritet me urdhër të Drejtuesit të Prokurorisë, në rastet kur:
 - a) punonjësi i proceduar vdes;
 - b) kur punonjësi i proceduar jep dorëheqjen nga atributet apo funksioni, dhe dorëheqja e tij pranohet nga organi i emërtesës.
2. Procedimi disiplinor pezullohet kur mbledhja e Komisionit Disiplinor duhet të shtyhet për shkaqe objektive për një periudhë më të gjatë se një muaj.

Neni 12
Pezullimi i punonjesit të proceduar disiplinarisht

1. Në rastet kur Komisioni propozon njërën nga masat e parashikuara nga neni 15/a, paragrafi 1, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit Nr. 8677 datë 12.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” (i ndryshuar), titullari i emërtesës ka të drejtë të pezullojë punonjësin e proceduar nga ushtrimi i funksioneve të Policisë Gjyqësore.
2. Vendimi i pezullimit ekzekutohet nga drejtuesi përkatës në varësinë administrative të të cilit është punonjësi i proceduar.
3. Gjatë periudhës së pezullimit punonjësi i policisë gjyqësore i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm, nuk paguhet. Në rastet kur ndaj punonjësit të policisë gjyqësore të pezulluar jepen masat disiplinore të parashikuara nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 15/a të ligjit nr. 8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, atij i jepet paga që nga momenti i pezullimit. Në këtë rast periudha e kohës së pezullimit nga detyra merret në konsideratë për llogaritjen e vjetërsisë në punë.
4. Marrëdhëniet financiare të punonjësit të policisë gjyqësore në varësi administrative të institucioneve publike, rregullohen sipas parashikimeve të ligjit organik të funksionimit të institucionit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 13
Vendimi i titullarit

1. Titullari i emërtesës vendos brenda 15 ditëve nga njoftimi i propozimit për masë disiplinore. Masa e pezullimit që parashikon paragrafi 7 i nenit 15 të ligjit 8677, datë 02.11.2000, (i ndryshuar), nuk mund ta kalojë këtë afat.
2. Titullari i emërtesës mund ta pranojë ose ta refuzojë masën disiplinore të propozuar vetëm me anën e një akti me shkrim.
3. Vendimi i titullarit është përfundimtar dhe i komunikohet, në çdo rast, Prokurorit të Përgjithshëm.
4. Prokurori i Përgjithshëm, në çdo rast, ka të drejtë të vendosë ndalimin e punonjësit të proceduar për të ushtruar funksione të Policisë Gjyqësore.

Neni 14
Afatet

1. Afatet që parashikon ky udhëzim nuk mund të zgjaten, përveç rasteve të pamundësisë të respektimit të tyre për shkaqe të arsyeshme. Në çdo rast, vendimi

duhet të merret jo më vonë se tre muaj nga data e regjistrimit të njoftimit të shkeljes disiplinore.

Neni 15

Administrimi i materialit të procedimit disiplinor

1. Masat e dhëna, në çdo rast, regjistrohen në dosjen vetjake të punonjësit të Policisë Gjyqësore. Ato shihen në përputhje me afatet e parashikuara në ligj.
2. Aktet e procedurës disiplinore ruhen në një dosje të veçantë në arkivin e prokurorisë.
3. Një kopje e akteve të procedurës disiplinore u dërgohet institucioneve publike në varësi administrative të të cilit është punonjësi i policisë gjyqësore i proceduar.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM



MINISTRI I BRENDSHËM

